



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.158

22 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i BSH nr.70, datë 30.09.2009	Për miratimin e rregullores “Për veprimtarinë valutore”	7051
Vendim i BSH nr.71, datë 14.10.2009	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit”	7062
Vendim i BSH nr.77, datë 28.10.2009	Për disa ndryshime në rregulloren “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”	7086

VENDIM
Nr.70, datë 30.09.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR VEPRIMTARINË VALUTORE”

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “c” të nenit 43 dhe shkronjave “d” dhe “dh” të pikës 3 të nenit 60 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për Veprimtarinë Valutore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit në Bankën e Shqipërisë për botimin e kësaj rregulloreje në Fletoren Zyrtare dhe publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Me hyrjen në fuqi të rregullore të miratuar me këtë vendim, rregullorja “Mbi veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin nr.64, datë 07.03.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, shfuqizohet.
5. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE
“PËR VEPRIMTARINË VALUTORE”

(Miratuar me vendimin nr.70, datë 30.09.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për kryerjen e veprimeve që regjistrohen në llogarinë korente dhe kapitale, në formën e pagesave dhe transfertave nga dhe në Republikën e Shqipërisë.
2. Veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni përfshijnë:
 - a) veprimet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve nëpërmjet përdorimit të mjeteve të pagesës në valutë; dhe
 - b) transferimin e njëanshëm të aktiveve nga dhe në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjithë personat juridikë që licencohen nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e veprimtarive bankare dhe/ose financiare.

Neni 3 Baza Ligjore

1. Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të:
 - a) nenit 60, paragrafi 3, shkronja “d” dhe “dh” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
 - b) ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”;
 - c) kreut IV, nenet 60, 61 dhe 62 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të tyre anëtare; ratifikuar me ligjin 9590, datë 27.07.2006 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të Shteteve të tyre anëtare”;
 - d) pikës 3, të nenit 1 të ligjit nr. 8648, datë 28.07.2000 “Për ratifikimin e Protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Marrakeshit” që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”.

Neni 4 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose përdorur në:
 - a) nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 23.12.2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”;
 - b) ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
 - c) ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”;
 - d) ligjin nr. 7764, datë 02.11.1993 “Për investimet e huaja”;
 - e) ligjin nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.
2. Përveç sa parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:
3. “Rezidentë” janë:
 - a) shoqëritë tregtare dhe personat e tjerë juridikë me zyrë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përjashtuar degët e tyre me seli jashtë territorit të Shqipërisë;
 - b) degët e shoqërive të huaja të regjistruara në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij;
 - c) dega e bankës së huaj e licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ushtruar veprimtari bankare dhe/ose financiare në Republikën e Shqipërisë sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi;
 - d) personat fizikë tregtarë, që në mënyrë të pavarur ushtrojnë një aktivitet tregtar si punësim parësor dhe që kanë qendrën e ushtrimit të aktivitetit dhe/ose vendbanimin e tyre në Republikën e Shqipërisë;
 - e) personat fizikë, të cilët kanë vendbanimin e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 12 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
 - f) personat fizikë/shtetasit e huaj, të cilët kanë vendqëndrimin në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 14 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, dhe të cilët disponojnë në mënyrë të vazhdueshme lejen e qëndrimit në Republikën e Shqipërisë në përputhje me ligjin nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të Huajt”;

g) diplomati ose punonjësi shqiptar së bashku me familjarët e tij, të caktuar me punë nga shteti shqiptar në ambasadë, konsullatë apo në organizma ndërkombëtarë jashtë shtetit, të cilët nuk kryejnë ndonjë aktivitet ekonomik apo tregtar;

h) personi fizik që ka vendqëndrimin jashtë Republikës së Shqipërisë, në kuptim të nenit 14 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i cili pavarësisht nga kohëzgjatja e qëndrimit jashtë Republikës së Shqipërisë është i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të Republikës së Shqipërisë.

4. Të gjithë personat e tjerë të cilët nuk përfshihen në përcaktimet e paragrafit 3 të këtij neni do të konsiderohen si “jorezidentë”.

5. “Mjet pagese në valutë” - është çdo mjet pagese në formën e kartëmonedhës apo monedhës metalike, të çekut, të kambialit, të premtim-pagesës, të letër-kreditit dhe të urdhrave ose të instrumenteve të tjerë të pagesës të emërtuar në monedha të huaja dhe që janë të pagueshme në monedha të huaja.

6. “Detyrim monetar” - është çdo detyrim për të paguar një shumë të caktuar parash, që paguhet (shlyhet) në vleftën e vet nominale, përveç se kur rezulton ndryshe nga ligji ose nga kontrata.

7. “Këmbim valutor” - është veprimtaria financiare e këmbimit të monedhës kombëtare në valutë dhe/ose anasjelltas, si dhe veprimtaria financiare e këmbimit të dy valutave me njëra tjetrën.

8. “Kurs këmbimi” - është çmimi relativ i një monedhe, i shprehur në njësinë e një monedhe tjetër, që përcaktohet lirisht në tregun e këmbimit valutor, referuar një date të caktuar.

9. “Valutë” janë mjetet financiare në formën e:

a) kartëmonedhave dhe monedhave të huaja të cilat kanë kurs ligjor ose në formën e parasë elektronike (e-money); dhe

b) fondeve dhe depozitave në monedhë të huaj pranë subjekteve bankare të huaja dhe të vendit, të cilat mund të transferohen me anë të mjeteve të pagesës për pagesat në valutë.

10. “Veprime të këmbimit valutor” janë:

a) këmbimi valutor në “cash” ose nëpërmjet llogarisë personale ose të të tretëve;

b) shlyerja e kredive dhe huave financiare në monedhë të ndryshme nga ajo me të cilën është akorduar ose pranuar, vetëm nëse kjo nuk është parashikuar në marrëveshjen fillestare me shkrim të palëve;

c) veprimtaria e shitblerjes së valutës në para fizike dhe çeqeve të udhëtarëve ushtruar nga subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë.

11. “Para fizike (cash)” - janë kartëmonedhat ose monedhat kombëtare dhe/ose të huaja në qarkullim.

12. “Njohja e titujve” - është fillimi i procedurave për tregtimin e titujve të huaj në Republikën e Shqipërisë ose të titujve të brendshëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

13. “Tituj të tregtueshëm në bursë” - janë titujt, tregtimi dhe çmimi i të cilëve është rregullisht i kontrolluar dhe i publikuar nga organet e bursës dhe/ose nga organet e lidhura me të.

14. “Tituj të tregtueshëm në tregun e kapitaleve” - janë aksionet, obligacionet dhe tituj të tjerë të tregtueshëm në tregjet e organizuara ose jo të organizuara të titujve.

15. “Titujt e tregtueshëm në tregun e parasë” - janë titujt me afat maturimi të shkurtër (me pak se një vit) të tillë si bonot e thesarit, dëftesat tregtare, certifikatat e depozitave, premtim-pagesat dhe instrumentet e tjerë të ngjashëm.

16. “Tregu i parasë” - është tregu financiar i huadhënies dhe huamarrjes afatshkurtër, që mundëson fonde likuide afatshkurtra në sistemin financiar. Në tregun e parasë, shiten dhe blihen lirisht, obligacionet afatshkurtra si bonot e thesarit, dëftesat tregtare certifikatat e depozitave të negociueshme, kambialet afatshkurtër etj..

17. “Tregu i kapitaleve” - është tregu ku personat fizikë dhe/ose juridikë tregtojnë titujt e tyre me qëllim sigurimin e shtimit të fondeve të tyre. Ky treg përbëhet nga: a) tregu primar; dhe b) tregu sekondar, si më poshtë:

a) “tregu primar” - është tregu në të cilin realizohet emetimi i titujve për herë të parë nga shoqëritë tregtare, qeveritë dhe institucionet e tjera publike dhe jopublike;

b) “tregu sekondar” - është tregu në të cilin kryhet rregullisht tregtimi i titujve të emetuar në tregun primar.

18. “Sipërmarrjet kolektive të investimit” - janë shoqëritë dhe/ose fondet e investimit, të cilat:

a) kanë si objekt investimin kolektiv të fondeve me origjinë nga publiku dhe që veprojnë mbi bazën e parimit të shpërndarjes së rrezikut; si dhe

b) njësitë e të cilave, me përjashtim të aseteve të këtyre shoqërive/fondeve, riblihen dhe shlyhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë sipas kërkesës së vetë zotëruesit/ve.

19. “Njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit” - janë titujt e emetuar nga shoqëritë/fondet kolektive të investimit, që përfaqësojnë të drejtat e pjesëmarrësve në aktivet e këtyre shoqërive.

20. “Tituj të brendshëm” - janë titujt dhe instrumentet e tjerë të borxhit të emetuar nga rezidentët.

21. “Tituj të huaj” - janë të gjithë titujt dhe instrumentet e tjerë të borxhit të emetuar nga jorezidentët.

22. “Transaksionet me titujt” - përfaqësojnë transferimin me apo pa shpërblim të pronësisë dhe/ose të të drejtave të tjera mbi titujt, ndërmjet një rezidenti dhe jorezidenti, për titujt e tregtueshëm në tregun e parasë dhe/ose të kapitaleve.

23. “Transaksion” - është marrëdhënia e biznesit që përfshin dy ose më shumë palë me qëllim shkëmbimin e një asemi kundrejt pagesës.

24. “Transaksionet e kapitalit” - janë veprimet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, me qëllim transferimin e kapitaleve, të cilat regjistrohen në llogarinë kapitale të bilancit të pagesave.

25. “Transaksionet korente” - janë veprimet të cilat nuk kanë si qëllim transferimin e kapitaleve dhe regjistrohen në llogarinë korente të bilancit të pagesave.

26. “Transferta të njëanshme të aktiveve nga dhe në Republikën e Shqipërisë” - janë transfertat të cilat nuk rrjedhin nga transaksione korente apo kapitale ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, por marrin formën e transfertave personale dhe fizike të aktiveve.

27. “Transferim” - është kalimi i një titulli pronësie, fondesh ose kapitali pas kryerjes së një transaksioni ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve, veprim, i cili regjistrohet në llogarinë kapitale dhe/ose në llogarinë korente të bilancit të pagesave.

28. “Investimet direkte” përfaqësojnë të gjitha llojet e investimeve brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentë dhe jorezidentë me qëllim krijimin dhe mbajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme ekonomike.

29. “Ar dhe metale të çmuara” janë:

a) ari dhe metalet e çmuara të standardizuara;

b) ari dhe metalet e çmuara të pa-standardizuara;

c) platini.

30. “Standardizim i arit dhe i metaleve të çmuara” - është forma unike e arit dhe/ose e metaleve të çmuara, e pranuar për t’u këmbyer në tregun ndërkombëtar të arit.

KREU II VEPRIMET VALUTORE

Neni 5 Llojet e veprimeve valutore

1. Veprimet valutore përfaqësojnë transaksione dhe/ose transfertat ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve dhe anasjelltas, të cilat regjistrohen në llogari të bilancit të pagesave të Republikës së Shqipërisë dhe përbëhen kryesisht nga:

a) transaksionet dhe transfertat kapitale;

b) transaksionet dhe transfertat korente.

2. Transfertat dhe transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve kryhen lirisht sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 6 Transaksione të kapitalit

1. Transaksionet e kapitalit të përshkruara në paragrafin 24, të nenit 4 të kësaj rregulloreje përfshijnë kryesisht:

- a) investimet direkte;
- b) investimet në pasuri të paluajtshme;
- c) transaksionet me titujt në tregun e kapitaleve;
- d) transaksionet me titujt në tregun e parasë;
- e) veprime me njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit;
- f) transaksionet që lidhen me ekzekutimin e kolateralit dhe/ose të garancive (hipoteka, pengu etj.);
- g) transaksionet e kreditit;
- h) transaksionet e depozitave;
- i) transfertat që rrjedhin nga kontratat e sigurimit dhe/ose të risigurimit, kur kjo lejohet nga legjislacioni shqiptar dhe në përputhje me ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.

2. Investimet direkte klasifikohen në:

- a) investime direkte në Republikën e Shqipërisë nga jorezidentët;
- b) investime direkte jashtë Republikës së Shqipërisë nga rezidentët.

3. Në transaksionet e investimeve direkte, të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, përfshihen kryesisht:

- a) krijimi ose hapja e degës ose zyrës së përfaqësimit të një shoqërie që zotërohet plotësisht nga personi që jep kapitalin/investuesi;
- b) krijimi i një filiali ose blerja e një shoqërie ekzistuese, e cila kalon në kontroll të plotë të investuesit;
- c) riorganizimi juridik i shoqërive (me bashkim ose me ndarje);
- d) pjesëmarrja në kapitalin aksioner të një shoqërie të re ose ekzistuese, nëse investuesi zotëron ose ka në pronësi mbi 10 për qind të pjesëmarrjes në kapitalin aksioner të shoqërisë ose mbi 10 për qind të të drejtave të votës;
- e) kreditë me afat maturimi më shumë se 5 vjet, që lidhen me transaksionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) përdorimi i fitimit nga një investim ekzistues në të njëjtin investim dhe me të njëjtin qëllim (riinvestimi i fitimit).

4. Investimet në pasuri të paluajtshme përfaqësojnë investimet e kryera nga rezidentët dhe jorezidentët me qëllim blerjen e këtyre pasurive si dhe ndërtimin për fitimin e pronësisë ose përdorim personal sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Në këto transaksione përfshihet dhe e drejta e uzufuktit ose të drejtat e përdorimit.

5. Në transaksionet e investimeve në pasuritë e paluajtshme, të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, përfshihen kryesisht:

- a) transfertat dhe transaksionet e kryera nga jorezidentët me objekt investimet në pasuritë e paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- b) transfertat dhe transaksionet e kryera nga rezidentët me objekt investimet në pasuritë e paluajtshme jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

6. Në transaksionet me titujt dhe instrumentet financiare derivativë në tregun e kapitaleve, përfshihen:

- a) transaksionet për blerjen nga jorezidentët të titujve dhe/ose instrumenteve financiare derivativë të brendshëm të tregtueshëm në bursë ose jo; dhe
- b) transaksionet për blerjen nga rezidentët të titujve dhe/ose instrumenteve financiare derivativë të huaj të tregtueshëm në bursë ose jo.

7. Për qëllime të kësaj rregulloreje, emetimi i titujve në tregun e kapitaleve përfshin:
 - a) njohjen e titujve në bursë;
 - b) emetimin dhe/ose listimin në tregun e kapitaleve, që përfshin:
 - i) pranimin e titujve të brendshëm në tregun e huaj të kapitaleve. dhe
 - ii) pranimin e titujve të huaj në tregun e brendshëm të kapitaleve.
8. Transaksionet me titujt dhe instrumentet e tjerë të tregut të parasë, përfshijnë:
 - a) transaksionet për blerjen nga jorezidentët të titujve të brendshëm në tregun e parasë; dhe
 - b) transaksionet për blerjen nga rezidentët të titujve të huaj në tregun e parasë.
9. Për qëllime të kësaj rregulloreje, emetimi i titujve në tregun e parasë përfshin:
 - a) njohjen e titujve në tregjet e parasë;
 - b) emetimin dhe/ose listimin e titujve në tregjet e parasë, që përfshin:
 - i) pranimin e titujve të brendshëm në tregun e huaj të parasë, dhe
 - ii) pranimin e titujve të huaj në tregun e brendshëm të parasë.
10. Veprime me njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit përfshijnë:
 - a) investimet e njësive në titujt e tregut të kapitaleve (aksione, obligacione etj.);
 - b) investimet e njësive në titujt ose instrumentet e tjerë të tregut të parasë;
 - c) investimet e njësive në asete të tjera.
11. Transaksionet me njësitë e sipërmarrjeve kolektive të investimit, përfshijnë:
 - a) transaksionet për blerjen nga jorezidentët të titujve të shoqërive rezidente, të tregtueshme ose jo në bursë; dhe
 - b) transaksionet për blerjen nga rezidentët të titujve të shoqërive të huaja jorezidente, të tregtueshme ose jo në bursë.
12. Administrimi i njësive të sipërmarrjeve kolektive të investimit në tregun e kapitaleve përfshin:
 - a) njohjen e titujve në tregun e kapitaleve;
 - b) emetimin dhe/ose listimin e titujve në tregun e kapitaleve, që përfshin:
 - i) pranimin e njësive të sipërmarrjeve kolektive rezidente të investimit, në tregun e huaj të kapitaleve, dhe
 - ii) pranimin e njësive të sipërmarrjeve kolektive jorezidente të investimit, në tregun e brendshëm të kapitaleve.
13. Transaksionet e kreditit përfshijnë transaksionet që kryhen mbi bazën e një kontrate kredie ndërmjet një rezidenti dhe jorezidenti si dhe anasjelltas. Transaksionet e kreditit përfshijnë:
 - a) kreditë tregtare, që lidhen me tregtinë ndërkombëtare të mallrave dhe/ose shërbimeve ku një nga palët është rezident, si dhe kreditë tregtare për pagesat e shtyra dhe/ose të avancuara;
 - b) transaksionet që lidhen me transferimin e të drejtave (faktoringu) të cilat kanë lindur nga një transaksion i karakterizuar si kredi tregtare;
 - c) kreditë të cilat nuk klasifikohen si kredi tregtare, me përjashtim të atyre të përcaktuara në pikën 3, shkronja “e” të këtij neni dhe pikës 2 të nenit 9 të kësaj rregulloreje.
14. Transaksionet e depozitave përfaqësojnë transaksionet e kryera në bazë të një kontrate, që përfshin hapjen e një llogarie rrjedhëse ose të një llogarie depozite nga një bankë rezidente në një bankë jorezidente, ose anasjelltas. Në transaksionet e depozitave përfshihen:
 - a) transaksionet ndërmjet rezidentëve dhe bankave jorezidente si dhe ndërmjet jorezidentëve dhe bankave rezidente;
 - b) transaksionet ndërmjet bankave rezidente dhe bankave jorezidente dhe anasjelltas; si dhe
 - c) transaksionet ndërmjet bankave rezidente dhe institucioneve të tjera financiare të huaja dhe anasjelltas.
15. Transaksionet që lidhen me ekzekutimin e kolateralit dhe/ose të garancive përfshijnë transaksionet e kryera në bazë të një kontrate midis rezidentëve dhe jorezidentëve dhe anasjelltas, të cilat janë në funksion të transaksioneve të përcaktuara në pikat 16 dhe 17 të këtij neni. Këto transaksione dallojnë në transaksione për ekzekutimin e kolateralit dhe/ose garancive:
 - a) të vendosura nga jorezidentët për rezidentët; dhe
 - b) të vendosura nga rezidentët për jorezidentët.

16. Transfertat në bazë të kontratës së sigurimit dhe të risigurimit, përfaqësojnë transaksione dhe transfertat të primeve dhe pagesave të cilat rrjedhin nga ekzekutimi i kontratave të sigurimit dhe risigurimit midis rezidentëve dhe jorezidentëve dhe anasjelltas.

17. Transfertat e kontratave të sigurimit dhe risigurimit të përcaktuara në pikën 16 të këtij neni, klasifikohen në:

- a) transfertat e primeve dhe pagesave në lidhje me sigurimin e jetës, si më poshtë:
 - i) kontratat e lidhura midis shoqërive vendase të sigurimit (siguruesi) dhe jorezidentëve (përfituesi), dhe
 - ii) kontratat e lidhura midis shoqërive të huaja të sigurimit (siguruesi) dhe rezidentëve (përfituesi).
 - b) transfertat të primeve dhe pagesave në lidhje me sigurimin e kredisë, si më poshtë:
 - i) kontratat e lidhura midis shoqërive vendase të sigurimit të kredive (siguruesi) dhe një jorezidenti (përfituesi), dhe
 - ii) kontratat e lidhura midis shoqërive të huaja të sigurimit të kredive (siguruesi) dhe një rezidenti (përfituesi).
 - c) transfertat të kapitalit mbi kontratat të tjera të sigurimit dhe marrëveshjeve të risigurimit.
18. Në kuptim të këtij neni, veprime në llogarinë kapitale do të konsiderohen edhe transaksionet e tjetërsimit të një investimi të kryera mbi baza ligjore.

Neni 7

Transaksionet korente

1. Transaksionet korente të përcaktuara në pikën 25, të nenit 4 të kësaj rregulloreje, përfshijnë kryesisht:

- a) të gjitha pagesat që rrjedhin nga tregtia ndërkombëtare e mallrave, shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera, përfshirë shërbimet dhe instrumentet bankarë afatshkurtër;
- b) pagesat e arkëtueshme për interesat e kredisë dhe për të ardhurat neto të investimeve të tjera;
- c) pagesat për shpërndarjen e fitimit bazuar në pjesëmarrjen në kapitalin themeltar si dhe pagesat që lidhen me një marrëdhënie kredie me investitorin direkt;
- d) transfertat e lidhura me dërgesat e emigrantëve dhe punonjësve jashtë Republikës së Shqipërisë, dërgesat e tjera për shpenzimet jetësore familjare, pensionet, ndihmat financiare për paaftësi pune dhe të tjera përfitime sociale, taksat dhe kuotat e anëtarësimit, transfertat që rrjedhin nga bashkëpunimi ndërqeveritar.

2. Transaksionet të cilat kryhen ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve dhe që regjistrohen në llogarinë korente të bilancit të pagesave mund të kryhen në monedha lirisht të konvertueshme.

3. Transaksionet dhe transfertat korente ndërmjet rezidentëve dhe jorezidentëve kryhen lirisht në përputhje me dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën nr. 1 të kësaj rregulloreje.

Neni 8

Transfertat e njëanshme

1. Transfertat e njëanshme, të përkufizuara në pikën 26 të nenit 4 të kësaj rregulloreje, përfshijnë transfertat personale të aktiveve dhe transfertat fizike të tyre.

2. Transfertat personale të aktiveve, përfshijnë transfertat me objekt transferimin e aktiveve nga dhe në Republikën e Shqipërisë, që rrjedhin nga huatë, dhuratat, trashëgimitë, shlyerja e detyrimeve nga emigrantët në vendbanimin e tyre të mëparshëm, transfertat e aktiveve të rezidentëve emigrantë për periudhën e qëndrimit të tyre jashtë vendit, të ardhurat nga lojërat e fatit dhe kursimet e personave jorezidentë të punësuar në Republikën e Shqipërisë.

3. Transfertat fizike të aktiveve, përfshijnë transportimin në “cash” të monedhës vendase ose të huaj, transferimin e arit dhe metaleve të çmuara si dhe titujt e transferueshëm.

4. Subjektet e licencuara kryejnë transferta të njëanshme të kapitalit për llogari të rezidentëve dhe të jorezidentëve, pas plotësimit të dokumentacionit që vërteton qëllimin e veprimit, të përcaktuar nga vetë subjekti.

KREU III TRANSFERIMI I KAPITALIT

Neni 9

Dokumentacioni për transferimin e kapitalit

1. Transferimi i kapitalit nga jashtë-brenda territorit të Republikës së Shqipërisë nga rezidentët dhe jorezidentët kryhet lirisht dhe pa kufizime.

2. Transferimi i kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të vetë subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, kryhet me vendim të organeve të tyre përkatëse dhe në përputhje me kërkesat rregullative/mbikëqyrëse të vendosura nga Banka e Shqipërisë.

3. Subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të klientëve të tyre pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si më poshtë, si dhe dokumenteve të tjera shtesë që subjektet mund të çmojnë të arsyeshëm:

a) për personat fizikë tregtarë dhe juridikë:

i) deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit dhe i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që kërkohet të transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet,

ii) vendimi i organit vendimmarrës të klientit për kryerjen e transferimit të kapitalit,

iii) ekstrakti i regjistrimit tregtar, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit,

iv) vërtetim i nga zyra e tatim-taksave, për shlyerjen e të gjitha detyrimeve fiskale ndaj shtetit.

b) për personat fizikë:

i) deklarimi i qëllimit të transferimit të kapitalit, deklarimi i burimit të krijimit të kapitalit që transferohet, shuma e kapitalit që transferohet jashtë Shqipërisë dhe adresa ku do të transferohet.

4. Në rastet e parashikuara më poshtë, subjektet e licencuara kryejnë transferimin e kapitalit nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për llogari të klientëve të tyre, vetëm pas plotësimit të dokumentacionit të përcaktuar si vijon:

a) kur kapitali i hyrë në Shqipëri, i transferuar nëpërmjet një banke jorezidente për qëllime investimi, nuk është përdorur, transferimi kryhet me paraqitjen në bankë të vendimit të organit vendimmarrës të subjektit që konfirmon ndërprerjen e investimit dhe mospërdorimin e shumës së kapitalit të derdhur për këtë qëllim;

b) për transferimin e kapitalit brenda shumës së kapitalit të regjistruar në Shqipëri dhe të ardhurave të siguruara nga investimi i kësaj shume, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni kërkohet dhe dokumentacion shtesë, si më poshtë:

i) vërtetimi i lëshuar nga organet e administratës fiskale për pagimin e detyrimeve fiskale lidhur me fitimin e realizuar, si dhe

ii) vendimi i organit vendimmarrës të subjektit, ku përcaktohet ndarja dhe përdorimi i fitimit.

c) për transaksionet e depozitave që përfshijnë veprimet në një llogari rrjedhëse ose në një llogari depozite nga territori i Republikës së Shqipërisë, kërkohen dokumente justifikues përkatës;

d) për kreditë tregtare me afat maturimi deri në një vit, që lidhen direkt me tregtinë ndërkombëtare dhe me ofrimin e shërbimeve, kërkohet si dokument kontrata e kredisë së lidhur midis rezidentit dhe jorezidentit;

e) për transferimin e valutës, që buron nga depozitat e një jorezidenti dhe/ose të ardhurat që rrjedhin prej tyre, si dokumentacion për transferimin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë shërben dokumenti i bankës, që vërteton shumën që transferohet nga depozita/t e tij;

f) për transferimin e valutës nga një emigrant në momentin e largimit nga Republika e Shqipërisë, nëpërmjet një banke apo institucioni financiar jobankë të licencuar nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e shërbimeve të transferimit të parave, kërkohet dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit të huaj që vërteton të drejtën e qëndrimit të tij në atë shtet;

g) për transferimin e të ardhurave të siguruara nga pasuria apo nga investimet e një emigranti shqiptar që jeton jashtë Shqipërisë, kërkohet dokumenti i parashikuar në shkronjën “f”, pika 4 të këtij neni, si dhe një deklaratë personale mbi burimin e të ardhurave që kërkon të transferojë;

h) për transferimin e kapitalit brenda shumës së kapitalit dhe të ardhurave që rezultojnë nga shitjet, nga likuidimi i pjesshëm ose i plotë i një investimi, kërkohet si dokumentacion shtesë edhe akti i shitjes ose akti i likuidimit nga organi kompetent, si dhe vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve fiskale.

5. Përveç sa parashikohet në këtë rregullore, për transaksionet e pagesave me jashtë në Republikën e Shqipërisë do të zbatohen njëkohësisht dhe rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të marrëveshjeve ndërbankare dypalëshe dhe/ose shumëpalëshe ku Banka e Shqipërisë është palë, si dhe zakoni bankar.

Neni 10

Investimet në tituj

Transaksionet me titujt dhe instrumentet e tjerë të ngjashëm, si dhe ushtrimi i të drejtave që rrjedhin prej tyre, kryhen vetëm nëpërmjet subjekteve bankare dhe/ose subjekteve të tjera të autorizuar nga legjislacioni përkatës, sipas një kontrate të përfunduar në lidhje me shërbimet përkatëse të ofruara.

KREU IV

LËVIZJET FIZIKE TË VALUTËS, TË ARIT DHE TË METALEVE TË ÇMUARA

Neni 11

Lëvizjet fizike të valutës në pikat doganore

1. Rezidentët dhe jorezidentët për shumat mbi 1 milion lekë ose kundërvleftën e tyre në valutë janë të detyruar të deklarojnë përpara autoriteteve doganore burimin dhe qëllimin e mbajtjes së tyre.

2. Jorezidentët që vizitojnë përkohësisht Republikën e Shqipërisë, mund të nxjerrin jashtë saj valutë në “cash” dhe/ose në çeqe udhëtarësh deri në shumën e deklaruar përpara autoriteteve doganore kur kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shumë justifikohet me paraqitjen e:

- a) deklaratës të plotësuar në momentin e hyrjes; dhe
- b) dokumentet që shoqërojnë ndryshimet nëse ka të tilla.

Neni 12

Lëvizjet fizike të arit dhe të metaleve të çmuara në pikat doganore

1. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të standardizuara vetëm nëpërmjet subjekteve të licencuara nga Banka e Shqipërisë, sipas përcaktimit të bërë në aneksin e licencës së dhënë nga kjo e fundit. Dokumentacioni, që duhet të plotësohet nga subjekti i cili ofron dhe kryen shërbimin e lëvizjes fizike të arit dhe metaleve të çmuara, përcaktohet në pikën 2 të këtij neni.

2. Rezidentët dhe jorezidentët kanë të drejtë të transferojnë nga brenda-jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, arin dhe metalet e çmuara të pastandardizuara nga pikat doganore, vetëm pas deklarimit në lidhje me:

- i) burimin (origjinën) e tij,

- ii) qëllimin e transferimit,
- iii) sasinë që kërkohet të transferohet,
- iv) kthimin ose jo të metaleve të çmuara, dhe
- v) formën e kthimit.

3. Dokumentacioni i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni nuk paraqitet për bizhuteritë e përdorimit personal.

KREU V RAPORTIMET DHE DOKUMENTACIONI

Neni 13

Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Subjektet e kësaj rregulloreje, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, raportojnë/dërgojnë të dhënat statistikore në përputhje me procedurat dhe sistemin raportues të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Neni 14

Detyrimet e subjekteve për dokumentacionin

1. Dokumentacioni i kërkuar në këtë rregullore dhe në shtojcën nr. 1 të saj paraqitet tek subjekti i licencuar nga Banka e Shqipërisë në origjinal, faks dhe/ose në fotokopje të noterizuara nga origjinali. Verifikimi i dokumentacionit kryhet nga subjekti i licencuar i cili bën fotokopjen e dokumentit të paraqitur dhe vendos një vulë të posaçme (datë) mbi secilën nga fletët e fotokopjuara, e cila i jep vlefshmërinë e duhur kopjes së dokumentit të mbajtur nga subjekti. Përveç sa më sipër, për aktin e zhdoganimit vulolet edhe origjinali.

2. Subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë janë të detyruara të plotësojnë dhe të ruajnë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare të gjithë dokumentacionin e parashikuar në këtë rregullore dhe në shtojcën nr.1 të saj. Në rastet kur kërkohet nga autoritet përgjegjëse për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, periudha e ruajtjes së këtij dokumentacioni mund të jetë më e gjatë.

KREU VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Dispozitë e fundit

Shtojca nr.1 bashkëlidhur kësaj rregulloreje është pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

SHTOJCA NR. 1

MBI “TRANSFERTAT PËR VEPRIMET TREGTARE DHE PËR VEPRIMET JOTREGTARE NË VALUTË”

I. Transfertat për veprimet tregtare me mallrat.

1. Transfertat për veprimet tregtare për mallrat, nga dhe në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga i njëjti subjekt (person fizik dhe/ose juridik) në një ditë pune kryhen kundrejt paraqitjes së dokumenteve të përcaktuar në pikat në vijim të kësaj shtojce.

2. Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë për çdo shumë në lekë ose ekuivalenten e saj në monedhë të huaj, të llogaritur me kursin e ditës së kryerjes së pagesës, duhet të paraqiten:

a) kërkesa për kryerjen e veprimit e nënshkruar nga vetë kërkuesi, ku pasqyrohet natyra e veprimit dhe qëllimi për të cilin kryhet ky veprim. Në këtë kërkesë, subjekti deklaron se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera për të njëjtin mall dhe vlerë;

b) fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës;

c) akti i zhdoganimit të mallit:

i) në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati, pagesa e radhës për këtë mall do të kryhet deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar apo të deklaratës së eksportit. Përfundimisht bëjnë rastet kur afati i lëvrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por në çdo rast jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj,

ii) në rastet e transfertave të pjesshme, kur veprohet me magazinë doganore, pagesa e radhës do të kryhet vetëm pas paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit, për atë pjesë të zhdoganuar të tij, që ka qenë nën regjimin e magazinimit doganor. Afati maksimal i paraqitjes së këtij dokumenti është 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e importimit. Lejohet shtyrja e këtij afati për 12 (dymbëdhjetë) muaj të tjerë, nëse pranohet nga organet kompetente duke iu referuar Kodit Doganor. Pas këtij afati, pagesa e radhës do të kryhet deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit ose deklaratës për eksportin e tij. Në të gjitha rastet, kryerja e pagesave nga subjektet dhe shtyrja e afateve të tyre do të bëhet në përputhje edhe me legjislacionin doganor në fuqi.

d) në rastin e likuidimit të menjëhershëm të shumës së përcaktuar në kontratë, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në 3 (tre) muaj pas kryerjes së pagesës. Përfundimisht bëjnë rastet kur afati i lëvrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por në çdo rast jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj.

3. Kur pagesa kryhet pas mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë, janë të zbatueshme:

a) kërkesa si në pikën 2, shkronja “a” të këtij neni;

b) akti i zhdoganimit të mallit ose vërtetimi i regjimit doganor nga organi përkatës (deklaratën e eksportit për rastet konkrete).

4. Për transfertat në tregun e mallrave, që kalojnë transit në Republikën e Shqipërisë, zbatohen kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

5. Në rastin kur blerja dhe shitja e mallit realizohet nëpërmjet dy shteteve të ndryshme nga Shqipëria dhe malli nuk hyn në Shqipëri, por vetëm pagesa e mallit realizohet nëpërmjet Shqipërisë, transferata kryhet duke u bazuar në dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2 të kësaj Shtojce. Kërkesa e paragrafit 2, shkronja “c”, plotësohet me aktin e zhdoganimit të mallit të njërit prej këtyre shteteve.

II. Transfertat për veprimet tregtare në rastin e shërbimeve.

Për transfertat tregtare që lidhen me pagesën e shërbimeve, sipas specifikimeve të bëra në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) kërkesën sipas pikës 2, shkronja “a” (pjesa I) të kësaj Shtojce;
- b) faturën përkatëse të subjektit ose dokumentin, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës; dhe/ose kontratën apo marrëveshjen përkatëse.

III. Transfertat për veprimet jotregtare.

Për transfertat jotregtare, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre, paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) kërkesën sipas pikës 2, shkronja “a” (pjesa I) të kësaj shtojce;
- b) deklarin e burimit të të ardhurave në lidhje me kryerjen e transfertës.

VENDIM

Nr.71, datë 14.10.2009

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 3, nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 26 pika 1 shkronja “a”, nenit 57 pikat 2, 3, 4 dhe 5, të nenit 58 pika 1 dhe nenit 66 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për administrimin e rrezikut të likuiditetit” dhe anekset nr.1 dhe nr.2 të saj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
 3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
 4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet udhëzimi “Për likuiditetin e bankave”, miratuar me vendimin nr.04, datë 19.01.2000, ndryshuar me vendimin nr.08, datë 12.02.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë
- Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI
Ardian Fullani**

BANKA E SHQIPËRISË KËSHILLI MBIKËQYRËS

RREGULLORE “PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT”

(Miratuar me vendimin nr.71, datë 14.10.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë).

KREU I TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kërkesave dhe standardeve minimale për administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit, nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 2

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë. Këto subjekte, këtu e më poshtë në këtë rregullore, do të quhen “banka”.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të nenit 3 pika 3, nenit 12 shkronja “a”, dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të nenit 26 pika 1 shkronja “a”, nenit 57 pikat 2,3, 4 dhe 5, të nenit 58 pika 1, dhe nenit 66 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4

Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në nenin 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

a) “Mungesë likuiditeti” do të konsiderohet çdo situatë në të cilën banka:

i) nuk disponon aktive likuide të mjaftueshme ose ka vështirësi për t'i realizuar ato në treg, me qëllim përmbushjen e detyrimeve kur ato maturohen dhe kërkohen nga depozituesit ose kreditorët e tjerë, ose

ii) nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

b) “Rreziku i likuiditetit” është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së likuiditetit;

c) “Kushte/situata jo të zakonshme” janë ato situata në të cilat ekziston një kërcënim real që mund të çojë bankën në mungesë likuiditeti;

d) “Plani i emergjencës” është një dokument i hartuar nga banka, në të cilin pasqyrohen rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur në kushte jo të zakonshme, si dhe procedurat për mundësimin e fondeve të emergjencës;

e) “Fluksi neto i parasë” është diferenca ndërmjet flukseve hyrëse dhe flukseve dalëse të parasë për një periudhë të përcaktuar kohe, duke u reflektuar kështu në rritje apo ulje të sasisë së cash-it;

f) “Maturiteti kontraktual i mbetur i të drejtave dhe detyrimeve” është periudha kohore e mbetur deri në përfundimin e afatit të maturimit të të drejtave dhe detyrimeve kontraktore;

g) “Përqendrimi në burimet e financimit” është gjendja kur një vendimmarrje e vetme apo një faktor i jashtëm i vetëm mund të shkaktojë tërheqje të menjëhershme dhe të konsiderueshme të fondeve, duke detyruar kështu bankën të ndryshojë ndjeshëm strategjinë e saj të financimit;

h) “Stress-test-ing” është teknikë e administrimit të rrezikut e përdorur për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të një ose me shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare dhe/ose likuiditetin e bankës. Stress test-et mund të përfshijnë analiza të skenarëve apo analiza të ndjeshmërisë;

i) “Depozitues të mëdhenj” konsiderohen njëzet depozituesit me vlerën më të madhe të depozitave në totalin e depozitave të bankës;

j) “Gap-i” është diferenca midis aktiveve dhe pasiveve të bankës, sipas intervaleve të maturitetit.

KREU II SISTEMI I ADMINISTRIMIT TË RREZIKUT TË LIKUIDITETIT

Neni 5 **Sistemi i administrimit**

1. Bankat krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim miradministrimin e rrezikut të likuiditetit. Bankat sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e bankës, tipologjinë e aktivitetit dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit përfshin minimalisht:

- a) strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- b) strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- c) sistemin e kontrollit të brendshëm;
- d) sistemin e administrimit të informacionit;
- e) planin e emergjencës.

Neni 6 **Strategjia dhe politikat**

1. Bankat hartojnë strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit.

2. Strategjia për administrimin e rrezikut të likuiditetit përmban minimalisht elementët e mëposhtëm:

- a) objektivat e strategjisë;
- b) parimet për administrimin e rrezikut të likuiditetit;
- c) metodologjinë e përgjithshme që banka do të zbatojë për administrimin e rrezikut të likuiditetit në periudha afatshkurtra dhe afatgjata;
- d) metodologjinë e përgjithshme dhe vizionin e bankës për të hyrë në shumë tregje dhe burime financimi; dhe
- e) politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit.

3. Strategjia për administrimin e rrezikut të likuiditetit hartohet si një dokument i veçantë ose si një pjesë e planit strategjik të bankës, dhe rishikohet periodikisht të paktën një herë në 2 (dy) vjet.

4. Politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit rishikohen periodikisht të paktën një herë në vit. Këto politika përfshijnë minimalisht elementët e mëposhtëm:

- a) identifikimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedh nga produkte dhe aktivitete të reja;

- b) matjen e rrezikut të likuiditetit, veçanërisht të:
 - i) pozicionit aktual të likuiditetit duke përfshirë vlerësimin e gjendjes së aktiveve likuide dhe të kolateraleve,
 - ii) parashikimin e flukseve hyrëse dhe flukseve dalëse të cash-it,
 - iii) krahasimin (match) e afatit të maturimit të fondeve dhe të burimeve të financimit,
 - iv) përqendrimin e depozitave dhe burimeve të tjera të financimit sipas maturiteteve, llojit dhe strukturës së klientelës,
 - v) nivelin e luhatshmërisë së depozitave,
 - vi) përcaktimin e treguesve të likuiditetit dhe përdorimin e tyre në procesin e monitorimit të likuiditetit në bankë,
 - vii) përdorimin e stress test-it si element/pjesë e monitorimit të rrezikut të likuiditetit.
- c) Vlerësimin periodik të ecures së tregjeve ku plotësohen nevojat për likuiditete.

Neni 7

Struktura organizative për administrimin e rrezikut të likuiditetit

1. Banka krijon strukturë organizative të përshtatshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit, si dhe përcakton qartë kompetencat dhe ndarjen e përgjegjësi të njëjve/funksioneve organizative të bankës që realizojnë monitorimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit.

2. Këshilli drejtues i bankës ose organi kompetent i bankës mëmë për degën e bankës së huaj, për qëllime të administrimit të rrezikut të likuiditetit kryen veprimet e mëposhtme:

a) shqyrton dhe miraton strategjinë, politikën/at dhe procedurat e administrimit të rrezikut të likuiditetit si dhe monitoron zbatimin e tyre, duke përfshirë miratimin dhe monitorimin e planit të emergjencës;

b) shqyrton çdo vit përshtatshmërinë e strategjisë dhe politikave të zbatuara, si dhe në çdo rast që paraqiten zhvillime të rëndësishme që ndikojnë në veprimtarinë e bankës;

c) miraton kufijtë e brendshëm të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit në përputhje me profilin e saj të rrezikut, strategjinë e biznesit dhe rolin e saj në sistemin financiar;

d) shqyrton dhe analizon raportin për administrimin e rrezikut të likuiditetit, shmangiet nga politikat e miratuara, si dhe miraton dhe monitoron strategjitë për rregullimin e këtyre shmangieve;

e) shqyrton rezultatet e gjeneruara nga stress test-et dhe përcakton, në përputhje me këto të fundit, masat për rregullimin e profilit të likuiditetit në përshtatje me tolerancën e rrezikut;

f) sigurohet që struktura/t përgjegjëse administron/jnë rrezikun e likuiditetit në mënyrë efektive, duke vlerësuar paralelisht rreziqet e tjera, veçanërisht ato të tregut dhe të kreditit;

g) vlerëson dhe monitoron efikasitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në funksion të administrimit të rrezikut të likuiditetit;

h) miraton procedurat e nevojshme për matjen dhe monitorimin e flukseve neto të parasë, si dhe për monitorimin e likuiditetit në monedhat kryesore dhe në total.

3. Këshilli drejtues i bankës ose organi kompetent i bankës mëmë për degën e bankës së huaj, krijon komitete/struktura për administrimin e rrezikut/qeve. Këto komitete/struktura, krahas administrimit të rreziqeve të tjera të subjektit, janë përgjegjëse edhe për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe realizojnë në funksion të këtij të fundit:

a) hartimin dhe zbatimin e strategjisë, politikave dhe procedurave për administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe dhënien e propozimeve për rishikimin e treguesve të tij;

b) zhvillimin dhe vlerësimin e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit me qëllim ruajtjen e efikasitetit të tij;

c) shqyrtimin e raporteve lidhur me gjendjen e likuiditetit të bankës dhe përcaktimin e monitorimin e veprimeve të nevojshme për administrimin e rrezikut të likuiditetit;

d) rishikimin periodik të kufijve të ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit dhe propozimin e ndryshimit të këtyre kufijve;

e) hartimin e metodologjisë së kryerjes së stress test-eve dhe procedurave për raportimin e rezultateve të gjeneruara prej tyre, si dhe raportimin periodik pranë Këshillit Drejtues mbi gjendjen dhe perspektivën e likuiditetit të bankës;

f) sugjeron zgjidhjen e çdo problemi potencial të likuiditetit dhe siguron vazhdimësinë e operacioneve të bankës;

g) siguron kushtet për funksionimin efektiv të sistemit të kontrollit të brendshëm;

h) çdo veprim tjetër që vlerësohet i nevojshëm në funksion të administrimit të rrezikut të likuiditetit.

4. Banka mund të krijojë edhe një strukturë/funksion të veçantë, e cila është përgjegjëse për zbatimin operacional të politikës së administrimit të rrezikut të likuiditetit nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit ditor të rrezikut të likuiditetit.

Neni 8

Sistemi i kontrollit të brendshëm

1. Banka miraton procedura për kontrollin e brendshëm, të cilat duhet të sigurojnë përfshirjen e procesit të administrimit të rrezikut të likuiditetit brenda procesit të administrimit të rrezikut në tërësi. Funksioni i kontrollit të brendshëm të administrimit të rrezikut të likuiditetit është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të bankës.

2. Funksioni i kontrollit të brendshëm për administrimin e rrezikut të likuiditetit përfshin minimalisht elementët e mëposhtëm:

a) monitorimin e përputhshmërisë së treguesve të likuiditetit me kufijtë e përcaktuar dhe raportimin mbi tejkalimet e mundshme të tyre;

b) kontrollin periodik të afateve, saktësisë dhe plotësisë së të dhënave dhe supozimeve të përdorura për qëllime të matjes dhe monitorimit të rrezikut të likuiditetit;

c) aplikimin e masave për korrigjimin e dobësive të konstatuara;

d) zhvillimin e vazhdueshëm të metodave dhe metodologjive për matjen dhe kontrollin e rrezikut të likuiditetit;

e) sigurimin e përputhshmërisë me të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet e tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë, si dhe me rregullat e brendshme të bankës.

Neni 9

Sistemi i administrimit të informacionit

1. Banka krijon një sistem informacioni, i cili siguron në kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme për procesin e vendimmarrjes, të dhënat e nevojshme për matjen, monitorimin, kontrollin dhe raportimin e treguesve të rrezikut të likuiditetit me qëllim administrimin e këtij të fundit.

2. Sistemi i informacionit i krijuar sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të sigurojë të dhëna dhe informacion minimalisht për çështjet e mëposhtme:

a) matjen, kontrollin dhe monitorimin e likuiditetit të bankës mbi baza ditore dhe në periudha kohore të përcaktuara qartë;

b) matjen, kontrollin dhe monitorimin e likuiditetit të bankës për çdo monedhë të huaj, e cila ndikon në mënyrë të konsiderueshme në likuiditetin e përgjithshëm të bankës, mbi baza individuale dhe të agreguara;

c) monitorimin e përputhshmërisë së treguesve të likuiditetit me kufijtë e përcaktuar për ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit;

d) gjenerimin e të dhënave me qëllim llogaritjen e treguesve të likuiditetit dhe përgatitjen e formave të raportimit për nevoja të strukturave drejtuese të bankës dhe të gjithë personave të tjerë të përfshirë në procesin e administrimit të rrezikut të likuiditetit;

e) raportet e përqendrimit të depozitave dhe monitorimin e qëndrueshmërisë së tyre;

f) Software për kryerjen e stress test-eve të likuiditetit.

Neni 10 Stress-testing

1. Banka administron likuiditetin jo vetëm në kushte/rrethana normale, por përgatitet për administrimin e tij dhe në kushte/rrethana të jashtëzakonshme.

2. Banka kryen në mënyrë periodike stress test-e, me qëllim identifikimin dhe matjen e ekspozimit të saj ndaj rrezikut të likuiditetit, si në kushte/situata normale të aktivitetit të përditshëm, ashtu dhe në situata jo të zakonshme. Për këtë qëllim, banka kryen analizën e ndikimit në fluksin e parave, të aftësisë paguese afatshkurtër dhe afatgjatë, të përgatitjes për të vepruar në kushte/situata jo të zakonshme, si dhe vlerëson kapacitetin e saj për të rritur aktivet nëpërmjet identifikimit të burimeve më të favorshme të financimit.

3. Periodiciteti me të cilën banka kryen stress test-et përcaktohet prej saj në përputhje me madhësinë e veprimtarisë së bankës, ekspozimin e saj ndaj rrezikut të likuiditetit dhe peshën e saj në sistemin bankar, me kusht që ky periodicitet të mos jetë më pak se 4 (katër) herë në vit. Banka e Shqipërisë mund t'i kërkojë në çdo rast bankës kryerjen e stress test-eve në periudha më të shpeshta.

4. Rezultatet e stress test-eve shqyrtohen nga Këshilli Drejtues i bankës të paktën çdo 3 (tre) muaj dhe përdoren për:

- a) përmirësimin e strategjive dhe politikave të administrimit të rrezikut të likuiditetit;
- b) hartimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullativ të nevojshëm për zgjidhjen e çështjeve kryesore lidhur me pozicionin e likuiditetit të bankës;
- c) zhvillimin e planeve efektive të emergjencës.

5. Stress-test-et e realizuara nga banka përfshijnë përdorimin e skenarëve të veçantë bazuar në faktorë të brendshëm, të skenarëve të bazuar në kushtet e tregut ku banka vepron, si dhe në faktorë makroekonomikë (faktorë të jashtëm).

6. Skenarët për kryerjen e stress test-eve mund të përfshijnë supozimet e mëposhtme:

- a) tërheqje masive të depozitave;
- b) përkeqësim i mundshëm i aftësisë së kredimarrësve për të shlyer detyrimet, që nënkupton përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë;
- c) pamundësi të konvertimit me lehtësi dhe pa humbje të konsiderueshme të aktiveve në cash;
- d) mundësinë e shlyerjes së parakohshme të detyrimeve në kushtet e ekzistencës së opsioneve kontraktuale që e mundësojnë këtë shlyerje;
- e) rrezikun operacional dhe shkallën e ndikimit të tij në rritjen e rrezikut të likuiditetit;
- f) ndryshimet në kushtet ekonomike në sektorët ndaj të cilëve banka është ekspozuar dhe përkeqësimin e ekonomisë në tërësi;
- g) përkeqësim të funksionimit të tregjeve në të cilat banka operon dhe/ose një reduktim të ndjeshëm të besimit në këto tregje;
- h) shock-un e normës së interesit dhe atë të kursit të këmbimit;
- i) efektin e ndryshimeve të ndjeshme në vlerën e aktiveve të bankës dhe/ose aktiveve të pranuar prej saj si garanci (kolateral);
- j) kufizimin e pjesshëm apo të plotë të financimit nga burimet kryesore të financimit, duke përfshirë mundësinë e vazhdueshmërisë së financimit nga banka mëmë;
- k) ndikimin e zhvillimeve negative ekonomike në shkallë rajonale dhe globale;
- l) çdo situatë tjetër të mundshme që vlerësohet si e përshtatshme.

7. Supozimet e renditura në pikën 6 të këtij neni kanë vlerë udhëzuese për bankën, ndërkohë që banka përdor ato situata që përshtaten më mirë me kompleksitetin, profilin e rrezikut dhe peshën e saj në sistemin bankar.

8. Banka përcakton metodologjinë për realizimin e stress test-eve, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, e cila përfshin:

- a) zbatimin, analizën e skenarëve të stress test-eve dhe periodicitetin e realizimit të tyre;
- b) realizimin e stress test-eve për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;

c) dokumentimin dhe rishikimin në mënyrë periodike të supozimeve të përdorura për kryerjen e stress test-eve;

d) formën dhe periodicitetin e raportimit të rezultateve të stress test-eve në strukturat drejtuese;

e) veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e veçanta të ngarkuara për administrimin e rrezikut të likuiditetit, mbështetur në rezultatet e stress test-eve.

Neni 11

Plani i emergjencës

1. Banka zhvillon një plan emergjence për administrimin e rrezikut të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme, të cilin e teston në mënyrë periodike të paktën çdo 2 (dy) vjet.

2. Plani i emergjencës është pjesë e sistemit të administrimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban:

a) ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësi dhe vendimmarrjes në lidhje me vënien në zbatim të planit;

b) treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjalizues për zhvillimin e kushteve të jashtëzakonshme si dhe përcaktimin e personave përgjegjës brenda bankës për monitorimin dhe raportimin e këtyre treguesve, disa prej këtyre treguesve parashikohen në Aneksin nr.1, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje;

c) kushtet në të cilat do të zbatohet plani;

d) përcaktimin e veprimtarive që duhet të ndërmerren, identifikimin e burimeve të mundshme të fondeve, nivelin e tyre dhe përparësitë në përdorim, si dhe përcaktimin e intervaleve kohore brenda të cilëve këto veprimtari duhet të ndërmerren;

e) komunikimin me depozituesit kryesorë, partnerët e biznesit, klientët e tjerë dhe publikun;

f) të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës për zbatimin e planit.

3. Banka e rishikon planin e emergjencës në mënyrë periodike, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve të mundshme të kushteve të brendshme dhe të jashtme të operacioneve të bankës.

4. Në kushte të situatave të vështirësive ekonomiko-financiare, banka bashkëpunon ngushtësisht me Bankën e Shqipërisë dhe shkëmben informacion të vazhdueshëm me të mbi gjendjen e saj financiare, si dhe mbi veprimet e ndërmarra për rikthimin e saj në parametra të kënaqshëm.

KREU III

PARIMET, TREGUESIT DHE MASAT PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT

Neni 12

Elementët kryesorë për identifikimin, vlerësimin dhe administrimin e rrezikut të likuiditetit

Banka identifikon, vlerëson dhe administron rrezikun e likuiditetit, duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:

a) parimet e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit;

b) planifikimin dhe monitorimin e fondeve (flukseve) hyrëse dhe dalëse;

c) përcaktimin dhe ruajtjen e një strukture të përshtatshme të maturitetit;

d) monitorimin e burimeve të financimit dhe përqendrimit të tyre;

e) monitorimin e garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit;

f) monitorimin e linjave të financimit;

g) normat e likuiditetit.

Neni 13

Parimet e administrimit të rrezikut të likuiditetit

Banka identifikon, vlerëson dhe administron rrezikun e likuiditetit, duke u bazuar minimalisht në parimet e mëposhtme:

- a) parimin e mbështetjes në burime të qëndrueshme financimi;
- b) parimin e minimizimit të diferencave midis maturiteteve në momentin e vlerësimit dhe atyre të parashikuara në kontratë;
- c) parimin e diversifikimit të burimeve të financimit sipas llojit, monedhës, instrumenteve, maturimit, numrit të klientëve dhe tregjeve, duke konsideruar nivelin e likuiditetit të tyre;
- d) parimin e zgjerimit të ekuilibruar/të kontrolluar të veprimtarisë dhe të ruajtjes së një vlere të mjaftueshme të aktiveve likuide;
- e) parimet e disponueshmërisë së burimeve njerëzore për administrimin efektiv të rrezikut të likuiditetit.

Neni 14

Planifikimi dhe monitorimi i fondeve (flukseve) hyrëse dhe dalëse

1. Banka parashikon dhe monitoron flukset hyrëse dhe dalëse të fondeve për periudha të caktuara kohe. Ky parashikim konsideron të gjitha llojet e flukseve hyrëse dhe dalëse, duke përfshirë dhe flukset hyrëse dhe dalëse nga zërat jashtë bilancit të bankës. Banka realizon në intervale periodike krahasimin e këtij parashikimi me vlerat aktuale të flukseve hyrëse dhe dalëse.

2. Parashikimet për flukset hyrëse përfshijnë minimalisht:

- a) shlyerjet aktuale të kredive (ku niveli i shlyerjeve nuk mund të jetë më i lartë se flukset hyrëse të kontraktuara, si dhe duke zbritur fondet rezervë të krijuara për humbjet e mundshme);
- b) konvertimin aktual në cash të aktiveve të cilat nuk kanë afat maturimi të përcaktuar;
- c) vlerat në cash të gjeneruara nga titujt e investimit;
- d) mundësitë aktuale të shitjes së aktiveve (ku investimet e kapitalit, kreditë me probleme dhe mjetet e qëndrueshme të trupëzuara trajtohen si aktive më pak likuide, duke përjashtuar flukset hyrëse nga ekzekutimi/et e kolateralit/ëve);
- e) rritjen e pritshme të depozitave;
- f) aftësinë e bankës për të siguruar fonde nga burime të tjera dhe disponueshmërinë e burimeve të tregut për financim;
- g) flukset e tjera hyrëse, bazuar në analizën e të dhënave historike mbi nivelet dhe ecurinë e flukseve hyrëse në periudhat e mëparshme, duke patur parasysh veçoritë e operacioneve të bankës, ndikimin sezonal, ndjeshmërinë e normës së interesit dhe faktorët makroekonomikë.

3. Parashikimet për flukset dalëse përfshijnë minimalisht:

- a) detyrimet që maturohen;
- b) rritjen e ardhshme të nivelit të kredidhënies së bankës;
- c) nivelet e depozitave dhe detyrimeve të tjera të qëndrueshme bazuar në luhatshmërinë e zakonshme të tyre dhe njohjen e sjelljes dhe interesave të depozituesve;
- d) depozitat me afat që mund të tërhiqen para afatit të maturimit dhe depozitat pa afat;
- e) ndikimin e ndryshimit të normës së interesit në nivelin e depozitave;
- f) nivelin e përqendrimit të depozitave;
- g) flukset dalëse nga zërat jashtë bilancit;
- h) flukse të tjera dalëse bazuar në analizën historike të të dhënave mbi nivelin dhe ecurinë e flukseve dalëse në periudhat e mëparshme, duke patur parasysh ndikimin sezonal, ndjeshmërinë e normës së interesit dhe faktorët makroekonomikë.

Neni 15

Përcaktimi dhe ruajtja e një strukture të përshtatshme maturiteti

1. Banka monitoron strukturën e maturitetit të aktiveve dhe të detyrimeve me qëllim identifikimin e gap-eve të mundshme të maturitetit.

2. Banka, për qëllime të matjes dhe monitorimit të gap-eve, klasifikon flukset hyrëse dhe dalëse nga aktivet (të drejtat), pasivet (detyrimet) dhe zërat jashtë bilancit, sipas intervaleve të maturimit.

3. Banka përdor si datë të arkëtimit të të drejtave datën më të fundit të mundshme të arkëtimit dhe si datë të shlyerjes së detyrimeve datën më të parë të mundshme të shlyerjes sipas intervaleve të mëposhtme:

- a) deri në 7 ditë,
- b) 7 ditë deri në 1 muaj,
- c) 1 muaj deri në 3 muaj,
- d) 3 muaj deri në 6 muaj,
- e) 6 muaj deri në 12 muaj.

4. Banka kryen në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e gap-eve sipas maturitetit të mbetur të pritshëm, duke përdorur për këtë qëllim parashikime rreth flukseve të pritshme hyrëse dhe dalëse, si për shembull ndër të tjera probabilitetin e mbledhjes së të drejtave në momentin kur ato maturohen, probabilitetin e tërheqjes së depozitave përpara maturimit.

5. Banka, në kuadrin e parashikimit të flukseve të ardhshme të parasë, sigurohet që supozimet e miratuara të jenë të arsyeshme, të përshtatshme, të dokumentuara dhe të rishikuara në mënyrë periodike.

6. Banka në përcaktimin e maturitetit të mbetur të të drejtave dhe detyrimeve, duhet:

a) të disponojë një bazë të dhënash të flukseve hyrëse dhe dalëse mbi të cilat janë mbështetur supozimet;

b) të rishikojë në mënyrë periodike supozimet e përdorura me qëllim pasqyrimin në këto të fundit të ndryshimeve të mundshme në kushtet e brendshme dhe të jashtme; si dhe

c) të sigurojë që supozimet të marrin në konsideratë karakterin sezonal dhe ciklik të flukseve hyrëse dhe dalëse.

7. Banka, sipas metodologjisë së miratuar, mund të klasifikojë (grupojë) flukset sipas llojit të klientit, maturitetit, monedhës, sektorit etj..

8. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë aplikimin e supozimeve të ndryshme apo të faktorëve korigjues në parashikimin dhe monitorimin e flukseve sipas maturitetit të pritshëm, në rast se gjykon se këto veprime mundësojnë një pasqyrim më të mirë të profilit të rrezikut të bankës.

9. Banka kryen analizën e gap-eve të likuiditetit duke u mbështetur kryesisht në kriteret e mëposhtme:

- a) klasifikimin e aktiveve, pasiveve dhe zërave jashtë bilancit sipas shportave të maturitetit;
- b) vlerësimin e qëndrueshmërisë së depozitave bazuar në të dhënat historike dhe rezultatet e stress test-eve;
- c) vendosjen e kufijve për gap-et e likuiditetit;
- d) përlllogaritjen e gap-eve mbi baza javore dhe sipas monedhave;
- e) parashikimin e gap-eve të likuiditetit në të ardhmen;
- f) çdo kriter tjetër që vlerësohet si i arsyeshëm.

Neni 16

Monitorimi i burimeve të financimit dhe përqendrimit të tyre

1. Banka monitoron në mënyrë periodike burimet e financimit me qëllim ruajtjen e një baze të diversifikuar të këtyre burimeve si dhe identifikimin e përqendrimeve të mundshme. Përqendrimet analizohen sipas burimit të financimit, llojit të financimit, tregut, përqendrimit gjeografik, monedhës dhe sipas maturitetit.

2. Monitorimi i burimeve të financimit dhe përqendrimit të tyre përfshin:
 - a) ruajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me depozituesit më të mëdhenj, bankat korrespondente, klientët e tjerë të rëndësishëm, si dhe me partnerët e biznesit;
 - b) përcaktimin e qëndrueshmërisë së depozitave, duke marrë në konsideratë karakteristikat e depozituesve dhe llojin e depozitës;
 - c) monitorimin e nivelit të diversifikimit të burimeve të financimit;
 - d) monitorimin e lëvizjeve në burimet e tjera të financimit.
3. Banka përcakton dhe monitoron nivelin e përqendrimit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat në monedhën vendase dhe në monedhë të huaj.

Neni 17

Monitorimi i garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit

1. Banka monitoron madhësinë/vlerën e garancive (kolateralit) të saj, me qëllim bërjen e dallimit midis aktiveve të vendosura si garanci (kolateral) dhe aktiveve të lira.
2. Monitorimi efektiv i garancive (kolateralit) synon përmbushjen e një tërësie kërkesash për kolateral lidhur me sigurimin e likuiditetit afatgjatë, afatshkurtër apo ndërditor.
3. Banka duhet të zotërojë madhësi të mjaftueshme të garancive (kolateralit) me qëllim përmbushjen e nevojave të pritshme apo të paparashikuara për huamarrje në tregun financiar, në tregun ndërbankar dhe nga Banka e Shqipërisë, mbështetur mbi profilin e saj të financimit.

Neni 18

Monitorimi i linjave të financimit

1. Banka vlerëson mundësinë e ripërsëritjes (rinegocimit) të linjave të financimit dhe mundësinë që siguruesit e fondeve të reagojnë në mënyrë të njëjtë edhe në rrethana/kushte jo të zakonshme.
2. Banka konsideron mundësinë (probabilitetin) e shterimit të mundësive për linja financimi në rrethana jo të zakonshme.
3. Banka nuk mund të supozojë ripërsëritjen (rinegocimin) automatike të sigurt në masën 100 (njëqind) për qind të linjave me afat maturimi njëditor.

Neni 19

Normat e likuiditetit

1. Banka mban likuiditetin në një shumë, strukturë dhe raporte që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, me një kosto të arsyeshme dhe me një rrezik minimal.
2. Banka harton dhe zbaton procedurat e nevojshme për matjen dhe monitorimin e flukseve neto të parasë, si dhe për monitorimin e likuiditetit në monedhat kryesore dhe në total.
3. Banka përllogarit dhe siguron respektimin e treguesit të aktiveve likuide ndaj pasiveve afatshkurtra në baza javore, në nivelin minimal 20 (njëzet) për qind.
4. Në përllogaritjen e aktiveve likuide përfshihen zërat e mëposhtëm:
 - a) arka;
 - b) llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në gjysmën e masës së përdorimit të saj;
 - c) bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”, të cilat nuk janë përdorur si garanci në një marrëveshje riblerjeje;
 - d) 80 (tetëdhjetë) për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”, të cilat nuk janë përdorur si garanci në një marrëveshje riblerjeje;

e) tituj “të investimit” të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj;

f) 80 (tetëdhjetë) për qind të titujve të qeverisë shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në shkronjat “c”, “d” dhe “e”, të kësaj dispozite, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë” dhe “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”;

g) bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë;

h) llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare;

i) depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë;

j) hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë (përfshihet llogaria 157 “hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”);

k) tituj “të tregtueshëm”/“të vendosjes” të emetuar nga qeveritë qendrore dhe/ose bankat qendrore dhe me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut të barazvlefshëm me vlerësimin e S&P jo më pak se A +;

l) tituj “të tregtueshëm”/“të vendosjes” të emetuar nga institucione financiare dhe me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut të barazvlefshëm me vlerësimin e S&P jo më pak se A +;

m) tituj “të tregtueshëm”/“të vendosjes” që nuk janë të vlerësuar, por të emetuar nga banka ndërkombëtare të zhvillimit të listuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankave”;

n) tituj “të investimit” me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj (duke përfshirë titujt e Qeverisë Shqiptare të përfshirë në shkronjat e mësipërme);

o) tituj të blerë sipas marrëveshjes së riblerjes (repo), kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë.

5. Aktivet likuide përfshihen mbi baza neto, duke përfshirë interesat e përllogaritura dhe duke zbritur fondet rezervë. Në rastin e vlerësimeve nga agjenci të ndryshme ndërkombëtare të rating-ut për të njëjtin titull, do të merret për bazë vlerësimi më i ulët.

6. Në përllogaritjen e pasiveve afatshkurtra përfshihen të gjitha detyrimet me afat maturimi të mbetur deri në 1 (një) vit. Në rastin e degës së bankës së huaj, në përllogaritjen e këtyre pasiveve afatshkurtra nuk përfshihen detyrimet ndaj bankës mëmë me afat të mbetur maturimi mbi 1 (një) muaj.

7. Banka, përveç treguesit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, monitoron dhe përcakton kur e gjykon të nevojshme kufij të brendshëm edhe për treguesit e mëposhtëm:

a) gap-i kumulativ deri në 1 (një) muaj ndaj aktiveve likuide;

b) gap-i kumulativ deri në 3 (tre) muaj ndaj aktiveve likuide;

c) kredi ndaj depozitave (të përllogaritur në total si dhe të ndarë në lekë dhe valutë);

d) kredi ndaj depozitave dhe linjave të financimit;

e) raporti i aktiveve likuide ndaj totalit të depozitave;

f) raporti i cash-it ndaj pasiveve afatshkurtra;

g) raporti i likuiditetit sipas intervaleve të maturitetit;

h) raporti i transformimit të maturimit të burimeve afatshkurtra në investime afatgjata;

i) treguesi i përqendrimit të depozitave (sipas llojit të depozituesit, monedhës, sektorit etj.) si dhe qëndrueshmëria e tyre;

j) kufijtë e vendosjeve pranë bankave të tjera;

k) parashikimi i nevojave të ardhshme për likuiditet (aktive likuide të disponueshme – aktive likuide të kërkuara).

Neni 20
Kërkesa raportuese

1. Bankat paraqesin në fund të çdo muaji në Bankën e Shqipërisë, formularët e përcaktuar në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje. Bankat respektojnë kufirin e treguesit të përcaktuar në nenin 19, paragrafi 3 të kësaj rregulloreje dhe raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë në rast të mosrespektimit të tij.

2. Bankat njoftojnë Bankën e Shqipërisë në çdo rast kur konstatojnë se mund të ndodhen përballë situatave të vështirësisë së likuiditetit, dhe në këto raste paraqesin një përshkrim të plotë të arsyeve që kanë shkaktuar këto situata, të efekteve që i shoqërojnë ato, si dhe të masave që parashikojnë të marrin për përmirësimin e tyre.

3. Banka e Shqipërisë, kur konstaton situata të vështira të likuiditetit ose kur ajo e gjykon të arsyeshme mund të kërkojë informacion më të zgjeruar dhe më të shpeshtë, si dhe mund të vendosë kërkesa dhe norma më kufizuese për administrimin e rrezikut të likuiditetit sesa ato të parashikuara në këtë rregullore. Në këto raste, bankat sigurojnë nëpërmjet strukturave përkatëse një komunikim sa më efektiv dhe informacion të plotë sipas kërkesës së Bankës së Shqipërisë.

Neni 21
Masat mbikëqyrëse

Banka e Shqipërisë, në rast mosplotësimi të detyrimeve të kësaj rregulloreje, zbaton dispozitat e parashikuara në nenet 74 deri 80 dhe në nenin 89, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij.

Neni 22
Dispozitë kalimtare

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të saj, kryejnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje rishikimin dhe/ose miratimin e rregulloreve, procedurave të brendshme, si dhe aplikimin e stress test-eve për administrimin e rrezikut të likuiditetit.

Neni 23
Dispozitë e fundit

Aneksi 1 dhe 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

ANEKSI 1
TREGUESIT E PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM

Lista e mëposhtme paraqet disa nga treguesit e paralajmërimit të hershëm që duhet të trajtohen me kujdes nga bankat. Kjo listë nuk është kufizuese por orientuese.

Treguesit e paralajmërimit të hershëm janë:

1. rritje e shpejtë e aktiveve, veçanërisht kur kjo rritje financohet me burime jo të qëndrueshme;
2. rritje e përqendrimit të aktiveve dhe/ose të detyrimeve;
3. rritje/ulje e madhe e pozicioneve neto në blerje/shitje sipas monedhave;
4. rënie e maturitetit mesatar të ponderuar të detyrimeve;
5. shkelje e vazhdueshme e kufijve të brendshëm apo atyre rregullatorë të përcaktuar për treguesit e likuiditetit;
6. trende negative dhe/ose rritje e rreziqeve të lidhura me një linjë produkti dhe/ose biznesi;
7. përkeqësim i ndjeshëm në të ardhurat e bankës, në cilësinë e aktiveve të saj dhe në situatën e përgjithshme financiare;
8. publicitet negativ;
9. përkeqësim në vlerësimet e rating-ut të bankës;
10. rënie në çmimin e aksioneve dhe/ose rritje e kostos së borxhit;
11. rritje e kostove të financimit me shumicë ose me pakicë;
12. kufizim apo shterim i linjave të kredive nga bankat korrespondente;
13. rritje në ritmin e tërheqjes së depozitave;
14. rritje në ritmin e tërheqjeve përpara maturimit të certifikatave të depozitave;
15. vështirësi në gjetjen e fondeve afatgjata;
16. etj..

ANEKSI 2

Formular Nr.1

Aktivët likuide - Pasivët afatshkurtra (në mijë lekë).

Banka _____

Datë _____

Aktivët likuide	Lekë	Usd	Euro	Të tjera
a. arka				
b. llogaritë me Bankën e Shqipërisë, duke përfshirë rezervën e detyrueshme deri në gjysmën e masës së përdorimit të saj				
c. bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”, të cilat nuk janë përdorur si garanci në një marrëveshje riblerjeje				
d. 80 (tetëdhjetë) për qind të obligacioneve të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të regjistruara në bilanc si “të tregtueshme”/“të vendosjes”, të cilat nuk janë përdorur si garanci në një marrëveshje riblerjeje				
e. titujt e “investimit” të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione) me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj				
f. 80 (tetëdhjetë) për qind të titujve të Qeverisë Shqiptare (bono thesari dhe obligacione), që nuk bëjnë pjesë në shkronjat “c”, “d” dhe “e”, të këtij formulari, por që plotësojnë kriteret e rregulloreve të Bankës së Shqipërisë “Mbi garancitë në operacionet kredituese të Bankës së Shqipërisë” dhe “Mbi marrëveshjet e riblerjes dhe të anasjellta të riblerjes”				
g. bonot e thesarit të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë				
h. llogaritë rrjedhëse në bankat dhe institucionet e tjera financiare				
i. depozita me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në 7 (shtatë) ditë				
j. hua për bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim të mbetur deri në shtatë ditë (përfshihet llogaria 157 “hua të pakthyera në afat ndaj bankave dhe institucioneve të tjera financiare”)				
k. titujt “e tregtueshëm”/“të vendosjes” të emeluar nga qeveritë qendrore dhe bankat qendrore me klasifikime nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A +				
l. titujt “e tregtueshëm”/“të vendosjes” të emeluar nga institucione financiare me vlerësim nga agjencitë ndërkombëtare të rating-ut ekuivalente me klasifikimin e S&P jo më pak se A +				
m. titujt “e tregtueshëm”/“të vendosjes” që nuk janë të vlerësuar, por të emeluar nga banka ndërkombëtare të zhvillimit të listuara në rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut nga				
n. titujt “e investimit” me maturim të mbetur deri në 1 (një) muaj (duke përfshirë letrat me vlerë të Qeverisë Shqiptare të përfshira në shkronjat e mësipërme)				
o. titujt e blerë sipas marrëveshjes së riblerjes, kur maturimi i mbetur i marrëveshjes së riblerjes është deri në 7 (shtatë) ditë				
TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE				
TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT				

Shënim: Të dhënat raportohen në kundërvleftën e tyre në lekë.

Formular Nr.2

Treguesi i likuiditetit në përqindje
(Aktive likuide/Pasive afatshkurtra)*100.

Banka _____

Datë _____

Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5

Shënim: Treguesi për javën 5 të muajit do të raportohet vetëm nëse ky i fundit rezulton të ketë në raste të veçanta 5 javë.

Formular Nr.3

Angazhimet e marra nga bankat mëma dhe bankat e tjera të grupit (në mijë lekë).

Banka _____

Datë _____

Kundërpartia	Monedha origjinale	Shuma në monedhë origjinale (shuma jashtë bilancit dhe pjesa e përdorur)	Kundërvlehtë në ALL	Maturiteti i mbetur	Pjesa e përdorur
1					
2					
...					
n					

Formular Nr.4

Përqendrimi i depozitave (në mijë lekë).

Banka _____

Datë _____

Përqendrimi i depozitave	Monedha	Shuma (kundërvlefta në lekë)	Depozitat sipas maturimit të mbetur					
			Deri në 7 ditë	7 ditë-1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	> 12 muaj
10 depozituesit më të mëdhenj	ALL							
10 depozituesit më të mëdhenj	EUR							
10 depozituesit më të mëdhenj	USD							
10 depozituesit më të mëdhenj	Të tjera							
20 depozituesit më të mëdhenj	ALL							
20 depozituesit më të mëdhenj	EUR							
20 depozituesit më të mëdhenj	USD							
20 depozituesit më të mëdhenj	Të tjera							
50 depozituesit më të mëdhenj	ALL							
50 depozituesit më të mëdhenj	EUR							
50 depozituesit më të mëdhenj	USD							
50 depozituesit më të mëdhenj	Të Tjera							

Formular Nr.5

Vendosjet pranë bankës mëmë, bankave të tjera të grupit dhe/ose institucioneve të tjera financiare (në mijë lekë).

Banka _____

Datë _____

Kundërpartia	Forma e vendosjes	Monedha origjinale	Shuma në monedhë origjinale	Kundërvlehta në ALL	Maturiteti i mbetur
1					
2					
...					
n					

Shënim: Forma e vendosjes nënkupton vendosje në formën e llogarive rrjedhëse, depozitë me afat, depozitë pa afat etj..

Formular Nr.6

Aktivët sipas shportave të maturitetit (në mijë lekë).

Banka _____

Datë _____

Kodi	Aktivët sipas maturimit të mbetur	Deri në 7 ditë	7 ditë – 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
1	VEPRIMET ME THESARIN DHE								
111	Arka								
1121 (A)	Llogari rriedhëse në bankën qendrore								
1122	Rezerva të detvrueshme								
1123	Depozita në bankën qendrore								
1124	Hua për bankën qendrore								
1127	Llogari të pakthvera në bankën qendrore								
1128	Llogari të tiera në bankën qendrore								
121	Bono thesari								
122	Bono të tjera të pranueshme për rifinancim me bankën qendrore								
13	Llogari rriedhëse në institucione								
14	Depozita në institucione financiare								
15	Hua për institucione financiare								
18 (A)	Llogari të tiera në institucione financiare								
19	Të dvshimta								
2	VEPRIMET ME KLIENTËT								
20	Hua standarde dhe paradhënie për klientët								
21	Hua dhe paradhënie të pakthvera në afat për klientët								
22	Hua në ndiekie								
23	Hua nënstandarde								
24	Hua të dvshimta								
25	Hua të humbura								
27 (A)	Llogari rriedhëse të klientëve								
28 (A)	Llogari të tiera të klientëve								

29	Llogari të për t'u arkëtuar të klientëve me status të dyshimtë të ndryshme nga huatë								
26	VEPRIME ME ADMINISTRATËN PUBLIKE								
261 (A)	Llogari rriedhëse								
262	Kredi								
266	Llogari të pakthvera në afat								
267	Llogari për t'u arkëtuar me status të dyshimtë								
269	Llogari të tjera								
3	TRANSAKSIONE TË LETRAVE ME VLERË								
31	Letra me vlerë me të ardhura fikse								
32	Letra me vlerë me të ardhura të ndryshueshme								
341	Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								
35(A) +	Të tjera								
41	MJETE TË TJERA								
43 (A)	VEPRIMET SI AGJENT								
44 (A)	LLOGARITË E MARRËDHENIEVE								
45(A)+ 46(A)	TË TJERA								
5	MJETE TË QËNDRUESHME								
51 + 52	Mjete të qëndrueshme të tjera								
53	Mjete të qëndrueshme të tjera								
	TOTALI								

Formular Nr.7

Pasivet sipas shportave të maturitetit (në mijë lekë).

Banka _____

Datë _____

Kodi	Pasivet sipas maturimit të mbetur	Deri në 7 ditë	7 ditë - 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	> 5 vjet	Totali
1	VEPRIMET ME THESARIN DHE NDËRBANKARE								
1121(P)	Llogari rriedhëse të bankës qendrore								
1125	Depozita të marra nga banka qendrore								
1126	Huamarrie nga banka qendrore								
1128(P)	Llogari të tiera me bankën qendrore								
1215	Bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								
1225	Bono të tjera të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								
13(P)	Llogari rriedhëse të institucioneve								
16	Depozita të marra nga institucionet financiare								
17	Huamarrie nga institucionet financiare								
18(P)	Llogari të tiera të institucioneve financiare								
2	VEPRIME ME KLIENTËT								
271	Llogari rriedhëse								
272	Llogari depozitash pa afat								
273	Llogari depozitash me afat								
28(P)	Llogari të tiera të klientëve								
26	VEPRIMET ME ADMINISTRATËN PUBLIKE								
261(P)	Llogari rriedhëse								
263	Llogari depozitash pa afat								
264	Llogari depozitash me afat								
265	Hua të marra nga administrata publike								

269(P)	Llogari të tiera të administratave publike								
3	VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË								
33	Borxhe të përfaqësuara nga letrat me vlerë								
342	Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes REPO								
35(P) +	Të tiera								
42	DETYRIME TË TJERA								
43(P)	VEPRIMET SI AGJENT								
44(P)	LLOGARI MARRËDHËNIESH								
45(P)+46(P)	TË TJERA								
5	BURIMET E PËRHERSHME								
54	Ndihmat dhe financimi publik								
55	Fornde rezervë								
56	Borxh i varur								
571+574	Kapitali i paguar (dhe diferenca e rivlerësimit)								
572	Primet e aksioneve								
573	Rezervat								
577	Fitimet e pashpërndara								
578	Fitimi i vitit në vazhdim								
	TOTALI								

Formular Nr.8

GAP sipas monedhave dhe shportave të maturitetit (në mijë lekë).

	Deri në 7 ditë	7 ditë-1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	>5vjet
USD							
A. Aktiv							
B. Pasiv							
Diferenca (A - B)							
C. Aktiv i zërave jashtë bilancit							
D. Pasiv i zërave jashtë bilancit							
Diferenca (C - D)							
E. Totali i Aktivit (A + C)							
F. Totali i Pasivit (B + D)							
Diferenca (E - F)							
EUR							
A. Aktiv							
B. Pasiv							
Diferenca (A - B)							

C. Aktiv i zërave jashtë bilancit							
D. Pasivi i zërave jashtë bilancit							
Diferenca (C - D)							
E. Totali i Aktivit (A + C)							
F. Totali i Pasivit (B + D)							
Diferenca (E - F)							
GBP							
A. Aktiv							
B. Pasivi							
Diferenca (A - B)							
C. Aktiv i zërave jashtë bilancit							
D. Pasivi i zërave jashtë bilancit							
Diferenca (C - D)							
E. Totali i Aktivit (A + C)							
F. Totali i Pasivit (B + D)							
Diferenca (E - F)							
CHF							

A. Aktivi							
B. Pasivi							
Diferenca (A - B)							
C. Aktivi i zërave jashtë bilancit							
D. Pasivi i zërave jashtë bilancit							
Diferenca (C - D)							
E. Totali i Aktivit (A + C)							
F. Totali i Pasivit (B + D)							
Diferenca (E - F)							

VENDIM
Nr.77, datë 28.10.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR PROCEDURAT E
PROKURIMIT NË BANKËN E SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat “c”, “f” dhe shkronja “g”, dhe nenit 76 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Administrimit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë disa ndryshime në rregulloren “Për procedurat e prokurimit në Bankën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 81, datë 15.11.2006 të Këshillit Mbikëqyrës, e ndryshuar, me përmbajtje si më poshtë:

a) në nenin 57, shtohet paragrafi i fundit me përmbajtjen e mëposhtme:

“Sipas rastit konkret dhe gjykimit të Komisionit të Prokurimit ose të Departamentit të Administrimit, në kontratat që parashikojnë pagesa pjesore për mallrat e lëvruar në parti apo të lëvruar dhe instaluar/montuar me faza, mund të parashikohet që vlera e sigurimit të kontratës të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore sipas periudhave të përcaktuara të kryerjes së lëvrimit dhe/ose instalimit/ montimit të mallrave”.

b) në nenin 58, shtohet paragrafi i parafundit, me përmbajtjen e mëposhtme:

“Në rastet kur Departamenti i Administrimit ose Komisioni i Prokurimit e gjykon të arsyeshme, në kontratë mund të parashikohet pagesa me anë të parapagimit (paradhënie), e cila mund të ndryshojë në varësi të çmimit të kontratës që do të lidhet. Në këtë rast, ofertuesi me të cilin do të nënshkruhet kontrata, duhet të bllokojë për llogari të Bankës së Shqipërisë “Sigurimin e kontratës” (neni 30 i kësaj rregulloreje), i cili duhet të jetë në një shumë të barabartë ose më të madhe (sipas rastit konkret) me shumën e parapagimit të dhënë nga Banka e Shqipërisë.

2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit dhe njësitë e tjera organizative të Bankës së Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Ardian Fullani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 20.11.2009
Doli nga shtypi më 22.11.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë